



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ENKELEIDA I. HOXHA
ADRESA Lagjia NR.5, Rr.
BLV"BAJRAM CURRI", GODINA 1
MAJI, AP. NR.22, HYRJA 3
TEL: 0682035826

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 3697

Nr. koleksioni: 1418

Tirane më 15/10/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024053570155591064



LËSHIMI I DËSHMISË
SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot para meje Notere **ENKELEIDA I. HOXHA**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tirane, me zyrë në adresën Tirane, Lagjia Nr.5, Rr. Blv "Bajram Curri", Godina 1 Maji, Ap. Nr.22, Hyrja 3, u paraqit personalisht:

KËRKUESE: Majlinda Pernoci, atësia Gjon, amësia Marie, shtetase Shqiptare, lindur në Shijak, Durrës dhe banues në Tiranë, me adresë Bajram Curri; Nd. 008; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 11/03/1973, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034475499 dhe nr. personal H35311050E.

OBJEKTI: Leshimin e Deshmise se Trashegimise Ligjore per trashegimlensesin **Paolo Hyseni**, i biri i Agron dhe Majlinda, lindur me date 02.07.1994 ne Tirane dhe banues ne Tirane, gjinia M, me gjendje civile beqar, me shtetesi shqiptare, vdekur ne date 24.09.2024.

BAZA LIGJORE: Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses e dokumentacionit ne prani te kerkueses **Majlinda Pernoci**, e cila kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit te saj, une Noterja:

V E R E J

Se kerkuesja **Majlinda Pernoci** eshte e ema te ndjerit **Paolo Hyseni**, ndaj ne baze te nenit 32 te Kodit te Procedures Civile, ai ka interes te ligjshem ne kete gjykim, pra legjitimohet te paraqese kerkimin para kesaj zyre noteriale.

Gjithashtu zyra ime noteriale Tirane, ne baze te nenit 318 te Kodit Civil, ka kompetencen tokesore per shqyrtimin e kerkeses, pasi vendbanimi i fundit i trashegimlensesit rezulton te kete qene ne Tirane.

Ne lidhje me pretendimin e kerkueses, para noteres u shtruan per zgjidhje keto çeshtje:

- Percaktimi i trashegimtareve te trashegimlensesit te kerkuar nga kerkuesja.
- Pjeset takuese te secilit prej tyre.

Per te zgjidhur keto probleme, une noterja i referohem nenit 318 te Kodit Civil, i cili ne lidhje me percaktimin e trashegimtareve te trashegimlensesit dhe pjeset takuese te secilit,



A2024053570155591064

ben te zbatueshem **ligjin e kohes se çeljes se trashegimise**, referuar rregullimit ligjor ne kohen e vdekjes se trashegimlensesit.

Rezulton e provuar se me date 24.09.2024 ka vdekur ne Tirane trashegimlensesi **Paolo Hyseni**, fakt qe vertetohet nga çertifikata e tij e vdekjes e dates 14.10.2024, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 377, Njesia Administrative Nr. 5, Tirane. Ne rastin konkret Ligji i zbatueshem eshte Ligji Nr.7850 date 29.07.1994 «Kodi Civil i Republikes se Shqiperise».

Nga verifikimi i bere prane Dhomes Kombetare te Notereve, sipas parashikimeve te Nenit 53, pika b, te Ligjit Nr.7829, date 01.06.1994 "Per Noterine", i ndryshuar, rezultoi qe trashegimlensesi te mos kete disponuar me testament ne lidhje me kalimin e pasurise se tij pas vdekjes. Ne keto rrethana kur nuk rezulton qe trashegimlensesi te kete disponuar pasurine e tij me testament, ne baze te nenit 317 te Kodit Civil do te zbatohet trashegimia ligjore.

Neni 361 i Kodit Civil aktual, percakton se: *«Ne radhe te pare thirren ne trashegim femijet dhe bashkeshorti i afte ose i paaftë per pune, duke trashëguar secili ne pjese te barabarta» duke vijuar, : "Kur përveç bashkëshortit, nuk ka trashëgimtarë të tjerë, të radhës së parë, në trashëgimi thirren ata të radhës pasardhëse, të parashikuar në nenin 363 të këtij Kodi dhe kur nuk ka të tillë, thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse, të parashikuar në nenin 364 të këtij Kodi"*

Neni 363 i Kodit Civil aktual, percakton se: *«Në radhë te dytë thirren në trashëgim prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë, të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjetonin me atë si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij.»*


Sic rezulton nga Certifikata Familjare e dates 14.10.2024 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 377, Bashkia Tirane, sipas Regjistrimit Kombetar te Gjendjes Civile te vitit 2010, i ndjeri ka qene me gjendje civile beqar, si i tille nuk ka trashëgimtar te radhes se pare.

Sa me siper thirren ne trashegim sipas nenit 363 te Kodit Civil prindërit e trashëgimlënësit, te cilet trashegojne ne pjese te barabarte.

Nga çertifikatat e prinderve te trashegimlensesit Majlinda Pernoci dhe Agron Hyseni, te administruara nga une Noterja, rezulton qe ata jane gjalle sot, si te tille kane qene gjalle ne kohen e vdekjes se trashegimlensesit, ndaj perfshihen ne rrethin e trashegimtareve ligjore te radhes se dyte te tij.

Nga hetimi nuk rezulton qe ndonje nga trashegimtarete e mesiperm te kete hequr dore nga trashegimia, te jene shpallur te padenje per te trashëguar me vendim gjykate, apo te jene perjashtuar nga trashegimia.

Kerkuesja me deklaroi se nuk ka trashëgimtare te tjere ligjore, pervec atyre te pasqyruar ne certifikatat familjare dhe certifikatat personale te depozituara prej tij.



A2024053570155591064

Per sa me lart, trashegimtare ligjore te trashegimlensesit **Paolo Hyseni** jane prinderit e tij: **Majlinda Pernoci dhe Agron Hyseni**, te cilet e trashegojne trashegimlensesin me 1/2 pjese te pandare te pasurise trashegimore te luajteshme dhe te paluajteshme secili dhe mbartin detyrimet e tij ne te njejten mase.

PER KETO ARSYE

Une Notere Enkeleida Hoxha duke u bazuar ne Nenet 316 e vijues, Nenet 348 e vijues te Kodit Civil dhe Ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Leshimin e Deshmise se Trashegimise Ligjore per trashegimlensesin **Paolo Hyseni**, duke percaktuar si trashegimtare ligjore te tij:

Agron Hyseni, atësia Laver, amësia Hazbie, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Bajram Curri; Nd. 008; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 02/06/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038431576 dhe nr. personal G90602056L, **i ati i trashegimlensesit.**

Majlinda Pernoci, atësia Gjon, amësia Marie, shtetase Shqiptare, lindur në Shijak, Durrës dhe banues në Tiranë, me adresë Bajram Curri; Nd. 008; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 11/03/1973, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034475499 dhe nr. personal H35311050E, **e ema e trashegimlensesit.**

Te cilet e trashegojne trashegimlensesin me 1/2 pjese te pandare te pasurise trashegimore te luajteshme dhe te paluajteshme secili, si dhe pergjigjen per detyrimet e tij trashegimore ne te njejten mase.

Kërkuesja mori dijeni dhe iu sqarua nga Noterja detyrimi ligjor për depozitimin e Dëshmisë së Trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajteshme, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë ditë kalendarike), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".

Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajteshme, nuk mund të çënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajteshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 "Për Noterinë".



A2024053570155591064

Gjithashtu nëse trashëgimlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese.

Kerkuesja mori dijëni qe, ne rast se i ndjeri ka pasur ne pronesi nje mjet rrugor, ka detyrimin qe te depoitoj kete Dëshmi Trashëgimie ne degen perkatese te DPSHTRR, per regjistrimin e ndryshimit te pronesise, brenda afatit ligjor prej 30 ditesh, duke filluar ky afat nga data e sotme e leshimit te saj, per te shmangur penalizimin nga orhanet e ngarkuara me ligj, referuar nenit 93 te Ligjit nr. 8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar.

Kerkuesja mori dijëni qe, ne rast se i ndjeri eshte regjistruar ne regjistrin tregtar ne kuptim te nenit 22 te Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, ka detyrimin qe te depozitoj kete Dëshmi Trashëgimie prane QKB, per regjistrimin e ndryshimit perkates, brenda afatit ligjor prej 30 ditesh, duke filluar ky afat nga data e sotme e leshimit te saj, per te shmangur penalitetin referuar nenti 74, pika 3 e Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Kerkuesja mori dijëni qe, ne rast se i ndjeri ka pasur ne pronesi nje mjet lundrues, ka detyrimin qe te depozitoj kete Dëshmi Trashëgimie prane ZRMLD-se, per regjistrimin e ndryshimit te pronesise, brenda afatit ligjor prej 10 ditesh, duke filluar ky afat nga data e sotme e leshimit te saj, per te shmangur penalitetin referuar nenit 14 te Ligjit Nr. 127/2020 "Per regjistrimin, menyren e perdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe te argetimit".

Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkuesses.

Kjo Dëshmi Trashëgimie përbëhet nga 5 (pese) fletë dhe lëshohet në kopje origjinale nga të cilët, njëra depozitohet në arkiven e zyrës noteriale, një kopje i dorëzohet kërkuesses për ta paraqitur në institucionet përkatëse (për aq pasuri sa disponon) dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve ligjorë. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", une Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Kundër këtij vendimi për lëshim Dëshmi Trashëgimie Ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Dëshmia e Trashëgimisë Ligjore lëshohet në Tirane, sot më datë 15/10/2024.

